

SHKARJET DREJTSHKRIMORE NË MEDIET E SHKRUARA, ELEKTRONIKE DHE NË RRJETET SOCIALE

Gonxhe GASHI¹, Luljeta ADILI-ÇELIKU²

¹Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë,

²Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi"

* gg30527@seeu.edu.mk, l.adili@flf.ukim.edu.mk

Abstract

Phenomenon of Albanian language culture is fading day by day. Today, one of the most painful issues of the standard Albanian language is the issue of not knowing the language culture, in general. The care to write and speak in accordance with the rules and the best models of the beautiful Albanian language has turned into extreme carelessness, ignoring and disregarding its laws, which, despite any violation that may be done to such laws, should be protected and respected by each of us. In the process of standardizing a language, the orthographic norm occupies a central place, tend to that process. But what's going on with the writing culture nowadays?

The frequent distortions made to the standard Albanian written language, which we notice every day, are numerous, enormous and unforgivable. Therefore, in order to see the miserable state of the Albanian language today and to successfully implement the issues that are raised within this topic that will be addressed some concrete examples of spelling errors in the written media, electronic and those in social networks. The spelling errors that will be treated are: the noun system, the verbal system, syntactic nature, lexical nature etc.

After the addressing of some spelling error issues, the factors that influence the ignorance of the culture of the language, which are numerous, will also be highlighted. These analyses and reviews will be handled through the theoretical analysis method, that is, by presenting the wrongly given examples with the correct forms provided by the spelling of the Albanian language. At the very end, relying on these factors, some recommendations will be given, how to solve the problems that are destroying the beautiful standard Albanian language and the injustices that are being done more and more to this language.

Key words: *media, errors, standard language, spelling, linguistic culture.*

Abstrakti

Dukuria e kulturës së gjuhës shqipe është duke u venitur dita-ditës. Sot, një ndër çështjet më të dhimbshme të gjuhës standarde shqipe është çështja e mosnjohjes së kulturës gjuhësore, në përgjithësi. Kujdesi për të shkruar e për të folur në përputhje me rregullat e modelet më të mira të gjuhës së bukur shqipe është shndërruar në një shkujdes të skajshëm, duke mënjanuar e shpërfillur ligjet e saj, të cilat, përkundër çdo shkeljeje që mund t'u bëhen këtyre ligjeve, duhen mbrojtur dhe respektuar nga secili prej nesh. Në procesin e standardizimit të një gjuhe, norma drejtshkrimore zë një vend qendror, duke i prirë atij procesi. Por, çfarë ngjet me kulturën e të shkruarit drejt në ditët e sotme?

Shtrembërimet e shpeshta që i bëhen gjuhës së shkruar standarde shqipe, të cilat i vëmë re çdo ditë, janë të shumta, tejet të mëdha dhe të pafalshme. Andaj, për ta parë gjendjen e mjeruar të gjuhës shqipe në ditët e sotme dhe për t'i realizuar suksesshëm çështjet e ngritura brenda kësaj teme që do të trajtohet, do të merren disa shembuj konkretë të shkarjeve drejtshkrimore në mediet e shkruara, elektronike dhe atyre në rrjetet sociale. Shkarjet drejtshkrimore që do të trajtohen janë: të sistemit emëror, të sistemit foljor, të natyrës sintaksore, të natyrës leksikore etj.

Pasi të jenë trajtuar disa nga çështjet e gabimeve drejtshkrimore, do të vihen në pah edhe faktorët që ndikojnë në mosnjohjen e kulturës së gjuhës, të cilët janë të shumtë. Këto analiza dhe shqyrtime do t'i trajtojmë përmes metodës së analizës teorike, si dhe, metodës krahasimtare, pra, duke i paraqitur shembujt e dhënë gabim me format e sakta, që parasheh drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

Ndërsa, krejt në fund, duke u mbështetur në këta faktorë, do të jepen disa rekomandime, se si mund t'u bëhet zgjidhje problemeve që po e shkatërrojnë gjuhën e bukur standarde shqipe dhe padrejtësitë që i bëhen, secilënherë e më shumë, kësaj gjuhe.

Fjalët kyçe: *medie, shkarje, gjuhë standarde, drejtshkrim, kulturë gjuhësore.*

Hyrje

Shkarjet drejtshkrimore në mediet tona elektronike, të shkruara dhe në rrjetet sociale janë aq të mëdha, saqë është e pamundur një shmangie e menjëhershme. Duhet shumë kohë për t'i vënë në binarë devijimet, çoroditjet, shtrembërimet dhe padrejtësitë e shumta që i bëhen gjuhës shqipe. Duke parë këtë gjendje, rregullat dhe thyerjet e tyre do të vazhdojnë të jenë të pranishme edhe për shumë kohë. Për t'u marrë me një studim mirëfilli për të gjitha këto parregullsi që i janë bërë nga mediet vendore gjuhës standarde shqipe, përveçqë duhet shumë kohë e gjatë për t'u vënë në vendin e duhur devijimet, nevojitet edhe shumë punë për të arritur në përfundime të dëshiruara.

Në ditët e sotme ka shumë faktorë që ndikojnë në dëmtimin e kulturës gjuhësore. Faktorët kryesorë që ndikojnë në të shkruarit jo të drejtë janë: niveli i dobët i arsimit në shkollën fillore dhe të mesme, llojet e komunikimit elektronik në komunikimin e përditshëm, ndikimi i gjuhës së internetit dhe i medieve në formimin gjuhësor të nxënësve ose të studentëve, mungesa e cilësisë së mësimdhënësve në institucionet arsimore dhe reflektimi i tyre te nxënësit dhe studentët, mosinteresimi i nxënësve dhe i studentëve për të lexuar libra, për t'u njohur me gjuhën dhe letërsinë etj. Rol të veçantë luan edhe mësuesi i parë i një nxënësi, sepse aty shtresohet themeli i parë i diturisë ndaj të shkruarit drejt. Mësuesi i parë (kur ndodh të jetë i mirë) mund të nxitë ndjenjën e dashurisë te një fëmijë për ta dashur drejtshkrimin dhe për të filluar ta përvetësojë atë, secilënherë e më shumë etj.

“Gabimet dhe shmangiet nga norma, na rrinë gjithmonë në pritë, pavarësisht nga përgatitja jonë gjuhësore” (Shkurtaç, 2017, f. 157).

Qëllimi për ta trajtuar këtë temë është që t'i shohim bashkë disa prej shkarjeve të shumta të medieve tona, të cilave shkarje, do t'u përgjigjemi me format e duhura për t'ua dhënë fjalive kuptimin e plotë dhe përçueshmërinë e saktë. *“Gjuha shqipe, si vlera jonë më e madhe kombëtare, kërkon përkujdesjen e të gjithëve, nga institucionet qeveritare e arsimore dhe deri tek individët.”* (Murati, 2021, f. 81).

Ngatërrimet midis ndajfoljeve dhe mbiemrave hasen mjaft shpesh në të shkruar. Për shembull: *“Drejtëpërdrejtë në debat me analistët...”* (S. Berisha). *“Drejtëpërdrejtë nga tubimi madhështor i fitores në Prishtinë”* (A. Kurti), që duhet shkruar *“drejtëpërdrejt”*, sepse, në këtë rast kemi të bëjmë me ndajfolje, ndërsa si mbiemër i nyjshëm shkruhet *“i/e/të/së drejtëpërdrejtë”*. *“Lutem për shërim sa më të shpejt të të gjithë të prekurve nga koronavirusi”* (H. Thaçi), që duhet shkruar: *“shërim sa më të shpejtë”* sepse bëhet fjalë për mbiemër, jo për ndajfolje si *“sa më shpejt”*. Ndërsa, në fjalinë: *“Kosova duhet të ketë koordinim më të ngusht me Amerikën”* (Dukagjini), fjala *“më të ngusht”* është shkruar gabim, sepse, si mbiemër, si ndajfolje shkruhet njësoj *“ngushtë”* dhe *“i/e/të/së ngushtë”*. Njësoj vlen edhe për fjalën *“sigurt”*, që nuk i vendoset ë-ja fundore asnjëherë (është çështje theksi). *“Falënderimi për Amerikën, duhet të jetë puna jonë më e drejt.”* (A. Reshitaj), që duhet të shkruhet *“më e drejtë”*. *“Këto fitore ngritën lartë moralin e popullit”* (Historia 7: f. 63), që duhet të shkruhet *“lart”*, sepse është ndajfolje, nuk është mbiemër dhe nuk ka nyjë për ta marrë një -ë fundore.

Përdorimin e gabuar të disa foljeve që nuk përkojnë me kohën apo mënyrën e vet, e hasim mjaft shpesh. “Në perudhën e feudalizmit **u ringjallë** jeta ekonomike.” (HISTORIA 7: f. 5). Folja “**u ringjall**” është shkruar me formant të vetës së tretë të lidhores me “**ë**”, gjë që është gabim dhe duhet të shkruhet “**u ringjall**”, sepse është folje e së kryerës së thjeshtë në vetën e tretë, në formë joveprore. “Kush kë e **pau** në ëndërr?” (LEXIMI LETRAR 7: f. 14), ku folja “**shoh**”, në këtë rast duhet të shkruhet “**pa**”. Kush? Ai. Kë? Atë e **pa**. Domethënë i referohet vetës së tretë njëjës.

Njëra ndër foljet që përdoret në mënyrë të ngatërruar është folja **zgjedh** në vend të foljes **zgjidh** dhe anasjelltas. Në Tv Dukagjini, personat përgjegjës shkruajnë: “**Është** absurde, përmes konkursit të **zgjedhet** këshilltari”. Në këtë fjali ka disa gabime. Fjala “**absurde**” shkruhet me dybuzoren e zëshme “**absurde**”; “**të zgjedhet**” duhet të shkruhet “**të zgjidhet**”, sepse është në vetën e tretë njëjës në të tashmen e dëftores, në formën joveprore, ku, pikërisht këtu bëhen ngatërresa, sepse, të dyja foljet: **zgjedh** dhe **zgjidh** dalin njësoj, por duhet t’i dallojmë nga konteksti i ndërtimit të fjalisë ose i ndërtimit të periudhës. Pra, **zgjidhet detyra** (**zgjidh**) dhe **zgjidhet kryetari** (**zgjedh**). “**Zgjedhet** një grup që do ta përgatisë mbledhjen” dhe “Ky person **zgjedhet** në bazë të përvojës...” (Edukata qytetare 7: f. 4). Në të dyja fjalitë, folja **zgjedh** është përdorur gabimisht. Ajo duhet të shkruhet **zgjidhet**, sepse në këtë vetë dhe në këtë formë foljore, si **zgjedh**, si **zgjidh**, zgjedhohen njësoj, veçqë dallohen sipas analogjisë. “**ZGJIDHEM** i. Pës. e **ZGJEDH**” (Shqipërisë, Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, 1980, f. 2060).

Pjesorja e foljeve në kohët analitike, në rastet kur kemi të bëjmë me disa nga foljet apofonike, merr formantin **-ur**, në vend të formantit të duhur **-ë** (është fjala për gabimet që bëhen), si në shembujt në vazhdim. Në kanalën televiziv T7 “Pressing” shkruan: “**Edi Rama** në raport me Kosovën në disa raste është **sjellur** keq”. Vërejmë disa gabime. Folja “**sjell**” është folje apofonike, që në të kryerën e thjeshtë bën “**solla**”, ndërsa pjesorja e saj del **-ë** në të kryerën e dëftores, jo **-ur**, kurrë, por “**sjellë**”. Në fjalinë e mësipërme është përdorur gabim “**është sjellur**” që është gabim i rëndë, e që duhej të ishte shkruar “**është sjellë**” që është në vetën e tretë pësore të së kryerës së dëftores. Fjalisë i mungojnë edhe presjet. “**Edi Rama**” në këtë fjali është një lloj përcaktori (ndajshim i veçuar), për t’u spikatur dhe saktësuar kuptimi i gjymtyrëve të tjera, ku duhen ndarë me presje fjalët ose grupet e fjalëve. Presja, në të shkruar, zëvendëson intonacionin, i cili mund të na ndihmojë se ku duhet vendosur një presje.

“**Veteranët e arsimit, i kuptojnë ndjenjat tona kombëtare më së miri, të njëjtat i kanë përcjellur te fëmijët tanë**” (R. Haradinaj), që duhet të shkruhet “**kanë përcjellë**”. “**Kjo trashëgimi përcjellet...**” (Art figurativ 7: f. 30), që duhet të shkruhet **përcillet** (f. në vetën e tretë, e kohës së tashme të dëftores, në formë joveprore). “**Doli për ta përcjellë; përcillem vetv.-përcillet**” (Shqipërisë, Fjalor i gjuhës shqipe, 2006, f. 783).

Njësoj, sikurse folja “**sjell**”, duhet të zgjedhohet edhe folja “**dal**”, në të gjitha mënyrat dhe në të gjitha kohët. Në të njëjtin emision televiziv (T7), është shkruar kështu: “**Duhet të kemi një president të dalur nga vota e qytetarit**”. Pjesorja e foljes “**dal**” e shkruar “**dalur**” është gabim i pafalshëm, që duhet të shkruhet “**dalë**” (edhe pse në këtë rast, më lart, është përdorur me kuptim përcaktori, mbiemri prejfoljor, jo si folje). “**Ne nuk mbesim pa bukë, nëse nuk ka dialog, por mbesim pa dalur jashtë**” (po aty), që duhet të shkruhet “**pa dalë**” (në formën e pashtjelluar mohore).

Të njëjtën folje e shkruajnë gabim të gjithë, kudo, në mënyrën urdhërore në njëjës dhe shumës. Kur bënim mësimin online, në Universitetin e Gjakovës, gjatë ecurisë së qasjes në ligjëratë, shkruante: “**Zgjedh lëndën-zgjedhni lëndën**” dhe “**Zgjedh-zgjedhni profesorin**”, të cilat janë të shkruara gabim, sepse në urdhërore, folja “**zgjedh**”, bën “**zgjidh-zgjidhni**”.

Folja “**zgjedh**” përdoret gabim edhe në të kryerën e thjeshtë: “*Mënyra se si u zgjedh Thaçi president, ka lënë shije të hidhur*”, që duhet shkruar “**u zgjodh**”: *u zgjodha, u zgjodhe, u zgjodh, u zgjodhëm* etj. **Mospërshtatja në kategori gramatikore e një pjese të ligjëratës me një tjetër pjesë të saj gjatë organizimit të fjalëve në fjali** ndodh të shihet mjaft shpesh edhe në libra shkollorë, si: “*Gjeni elementet përshkrues*” (GJUHA SHQIPE 8: f. 86), që emrit të dygjinishëm (ambigjen) “**elementet**”, i duhet përshtatur mbiemri në gjininë femërore të shumësit “**përshkruese**”. Po aty, është shkruar pa përshtatje gjinie togfjalëshi përemëror “*ato muaj*”, që duhet të shkruhet “*ata muaj*”, sepse “**muaj**” është emër i gjinisë mashkullore: **muaj-i** dhe **muaj-të**. Në një libër tjetër (GJUHA SHQIPE 10: f. 35) shkruan: “**elementet e saj strukturorë**”. Prapë i njëjti gabim. Nuk përshtatet mbiemri me emrin në gjini. Po aty (f. 17) shkruan: “*Nxirrni fjalët nga të tre tekstet*”, që duhet të shkruhet “*nga të tria tekstet*”, për t’u përshtatur njëra fjalë me tjetrën. “*Numërori tre me kuptim përmbledhës e ruan gjithmonë kategorinë e gjinisë*” (Shqipërisë, 2002, f. 210).

“*Njerëzit më besnik*” (HISTORIA 7: f. 3), nuk ka përshtatje të mbiemrit me emrin në kategorinë e numrit. Mbiemri “**besnik**” është shkruar në njëjës pa prapashtesën “-ë” që tregon shumësin e këtij emri, e që i duhet referuar emrit “**njeri**” në shumës “**njerëzit**”, pastaj të shkruhet: “*njerëzit më besnikë*”. Po aty, shkruan: “**Intelektual të shquar shqiptar**”, ku sipas nyjës së mbiemrit “**të shquar**”, nënkuptohet se fjalët “**intelektual**” dhe “**shqiptar**” janë në shumës, që duheshin shkruar: “**Intelektualë të shquar shqiptarë**”. Në të njëjtin libër ndodhen edhe këto gabime: “*Ata u bënë shumë aktiv*” (f. 49), që duhet të shkruhet “**aktivë**”, sepse fjala i referohet shumësit “**ata**”. “*Princërit arbëror*”, “*pushtuesit osman*”, duhet të shkruhen: “**Princërit arbërorë**” (edhe *princat arbërorë* bën), “**pushtuesit ormanë**” etj.

Foljeve në mënyrën urdhërore, edhe pse zgjedhohen vetëm në vetën e dytë njëjës dhe shumës, duhet t’u kushtohet shumë vëmendje, sepse, përveçqë disa folje pësojnë ndryshime gjatë zgjedhimit në këtë mënyrë foljore, krijohet edhe një marrëdhënie me vetën e tretë njëjës ose shumës, zakonisht me emra të rasave dhanore dhe kallëzore dhe me përemra që u përgjigjen këtyre rasave, e që shfaqen me mjaft ndërlikime në të shkruar.

Në reklamat televizive, shumë shpesh përdoret (shkruhet dhe shqiptohet) folja “**blej**” kështu: “*blej nga shtëpia*”, në vend se: “*bli nga shtëpia*”, “*bleni nga shtëpia*”, që duhet të shkruhet “*blini nga shtëpia*”. “**Vështroni hartën dhe tregoni sa familje gjuhësore ka në botë**” (GJUHA SHQIPE 9: f. 15). Folja “**vështroni**”, në këtë rast i referohet kundrinës së drejtë në rasën kallëzore pa parafjalë “*hartën*” dhe duhet të shkruhet me trajtën e shkurtër të vendosur brenda fjalës me mbaresën e shumësit **vështro-j-e-ni** hartën. “**Lexoni tekstin**” (po aty: f. 25), që duhet të shkruhet “**lexojeni tekstin**”. “*Foljet që dalin me zanore, kur bashkohen me trajtat e shkurtra e, i, u dhe ua marrin -j-: mëso-nësoje etj.*” (Beci, 2010, f. 133). Edhe në librin “GJUHA SHQIPE 8” f. 155, shkruan: “**Lexoni tekstin e mësipërm**”, që duhet të shkruhet: “**lexo-j-e-ni tekstin**”.

Pastaj, kur një formë e vetës së dytë njëjës në mënyrën urdhërore mbaron me një zanore, kur bëhet lidhja me vetën e tretë, ndiqet me një trajtë të shkurtër të përemrave vetorë dhe shtohet një **-j-** për t’u lehtësuar shqiptimi, si: “**Kthe në ligjëratë të zhdrejtë këto vargje**” (LEXIMI 5: f. 123), që duhet të shkruhet: “**kthe-j-i në ligjëratë të zhdrejtë këto vargje**”. “**Shkruaj një tekst të shkurtër me tre paragrafë**” (po aty: f. 16), që duhet të shkruhet: “**Shkruaje një tekst**”, ndërsa mund të shkruhet “**shkruaj**” si në fjalinë: “**Shkruaj, si u kremtua festa e djeshme**”. “**Gjej dhe lexo “Poemin kosovar” të Mitrush Kutelit!**” (LEXIMI 5: f. 17), që duhet të shkruhen: “**gje-j-e**” dhe “**lexo-j-e**”, sepse fjalëve *gjej* dhe *lexo* do të mund t’u bëhet pyetja **çka; çka të lexoj?** Ndërsa fjalëve *gjeje* dhe *lexoje* u bëhet pyetja **kë; kë ta lexoj; atë e, pra lexoje**.

Po aty (f. 20), shkruan: “*Nxirr nga teksti të gjithë emrat*”, që duhet të shkruhet “*nxirri emrat*”. “*Lexo dhe mëso përmendsh poezinë*” (LEXIMI 7: f. 12), që të dyja foljet duheshin shkruar: “*lexoje dhe mësoje poezinë*”. Kur folja është në vetën e dytë njëjës dhe i referohet vetës së tretë në shumës, trajta e shkurtër brenda fjalës del në këso forma: **tre-go-j-u**, që do të thotë, **atyre u tre-go**. Pastaj, **tre-go-j-ua-atyre ua tre-go**. Ndërsa, kur folja e urdhërtores është në shumës dhe kur bëhet lidhja me vetën e tretë njëjës del me këto forma: **tre-go-jini-atij/asaj i tregoni**, p. sh. **tre-go-jini atij/asaj për mësimin e djeshëm, tre-go-ja-ni atij/asaj të vërtetën-ia tregoni të vërtetën, ndihmo-j-e-ni atë-e ndihmoni atë** etj., ndërsa, kur folja në shumës lidhet me vetën e tretë shumës merr këto forma: **tre-go-j-u atyre!-u tre-go atyre-tre-go-j-ua të vërtetën atyre-ua tre-go të vërtetën atyre, tre-gojuani të vërtetën ayre-ju, ua tregoni atyre të vërtetën** etj.

Foljeve në mënyrën urdhërore, mund t’u ngjiten edhe trajta të shkurtra të vetës së parë, pra, ekziston një marrëdhënie edhe me vetën e parë, si për njëjës: **tre-go-më-mua më tre-go, shkruamë-mua më shkruaj; bëmë, merrmë, gjëmë** etj., ndërsa për shumës: **tre-go-më-ni-mua më tregoni, merrmëni-mua më merrni** etj.

Disa foljeve të vetës së tretë të të tashmes së dëftores u shtohen pa nevojë formante të vetës së tretë të lidhores: “Ngjyra e gjelbër **nxitë** ndjenjën për qetësim” (Edukata figurative 4: f.17), që duhet të shkruhet **nxit**, ndërsa, kur të jetë shkruar në vetën e tretë në të tashmen e lidhores, shkruhet **të nxitë**. “Ngjyra e verdhë **ngjallë** ndjenja të ngrohta dhe **ngritë** vullnetin.” (Po aty: f.17), që duhet të shkruhen: **ngjall** dhe **ngrit**. “Arti figurativ **shprehë** ndjenjat dhe mendimet”, në vend se **shpreh**.

Përdorimet e gabuara të trajtave të shkurtra në mediet tona konsiderohet të jenë problemet më mëdha në të shkruar.

“Trajatat e shkurtra të përemrave vetorë funksionojnë në gjuhë si caktuesorë të foljeve, duke shenjuar kalimtarësinë e foljeve dhe formësimin semantik të tyre” (Çeliku, 2012, f. 168). Mospërdorimi i drejtë i trajtave të shkurtra në gjuhë, ua humbet fjalive kuptimin e dëshiruar, duke e çorientuar gjithë organizimin sintaksor të fjalëve brenda një fjalie.

Në mediet tona, trajtat e shkurtra përdoren kështu: “*Ka diskriminim të thellë sa i përket çështjeve në familje*”, që duhet të shkruhet: “*sa u përket çështjeve*” (Tv Dukagjini). “*PDK nuk i frikësohet zgjedhjeve*” (po aty), që duhet: “*PDK-ja nuk u frikësohet zgjedhjeve*”, sepse trajta e shkurtër **u** i referohet shumësit, *kujt? Atyre u, zgjedhjeve*.

“*Profesori Ukshin Hoti i përket intelektualëve të profilit të lartë*” (H. Thaçi), që duhet ta shkruajmë “*Ai u përket*”, atyre u përket, “*intelektualëve*”, ndërsa, të kishte thënë “*i përket profilit të intelektualëve...*”, do të ishte përshtatur me njëjës, por në shembullin e mësipërm është shkruar gabim.

Trajtat e shkurtra, që shërbejnë si mjete gramatikore për të treguar vetën e veprimit, duke kryer funksion sintaksor, njëkohësisht kryejnë edhe funksion morfologjik e semantik, kështu, kur t’i përdorim ato (gjithmonë vetëm në rasën dhanore dhe kallëzore), duhet t’ua përshtatim fjalëve që vijnë pas tyre, të cilat na ndihmojnë për t’i përcaktuar trajtat e shkurtra, po edhe fjalëve që ndodhen para tyre.

“*Sejdiu thotë se mjekëve duhet t’i sigurohen vende të punës*” (Express), që duhet “*mjekëve duhet t’u sigurohen*”, sepse fjala shoqëruese është në shumës. “*Nëse nuk mund tu sigurohen vende të punës*” (po aty), duhet shkruar: “*t’u sigurohen vende të punës*”. “*Unë do t’iu rekomandoja edhe juve të përdorni serumin Iuvenus, pasi përmban rigjenerues që u nevoiten lëkurës suaj*” (Telegrafi). Kjo fjali është krejtësisht gabim. Nuk ka ndërtim. Do të duhej: “*Unë jua rekomandoj ta përdorni serumin Iuvenus, i cili përmban elemente rigjeneruese (përtëritëse), të cilat i nevojiten lëkurës suaj*”.

Në gazetën “Panorama”, gjithashtu, gjejmë gabime të shumta të përdorimit të trajtave të shkurtra: “Nuk do të kërkohen certifikata të vaksinimit për **tu** futur në dyqane”, që duhet: “për **t’u** futur në dyqane”. Pastaj, më mirë do të ishte të përdorej “për të hyrë në dyqane”. Një shembull tjetër në gazetën “Fama”: “Enver Hoxha **i** nxori qumështin shqiptarëve nga hundët”, që duhet shkruar: *Enver Hoxha **ua** nxori qumështin nga hundët shqiptarëve.*

Politikanët tanë në rrjetet sociale shkruajnë kështu: “Të gjithë qytetarëve të besimit islam, **iu** uroj muajin e ramazanit” (R. Haradinaj), që duhet “**ua** uroj”. “Stereotipet diskriminuese gjinore **i** kanë mohuar vajzave dhe grave qasjen e barabartë për të bërë karrierë” (A. Kurti), që duhet: “**ua** kanë mohuar vajzave dhe grave qasjen e barabartë”. “Ka rritje ekonomike dhe të të hyrave buxhetore, që sot **ju** kthehen nga Qeveria e Kosovës atyre në nevojë” (M. Kusari-Lila), që duhet shkruar: “**iu** kthehen atyre”. “Kreu i organizatave kriminale, **i** thotë ministrave të vjedhin, por mos të denoncohen” (S. Berisha), që duhet të shkruhet: “**u** thotë ministrave”, sepse trajta e shkurtër ka të bëjë me shumësin e rasës dhanore. “Edi Rama, shpresëvrasësi, po i largon studentët nga vendi, po **u** vret shpresat” (S. Berisha), që duhet shkruar: “po **ua** vret shpresat”.

Trajtat e shkurtra përdoren edhe brenda fjalës, në fund ose trup fjalës si: “Pëlqene faqen time!” (A. Osmani), që duhet të shkruhet: “**Pëlqejeni**”, atë e **pëlqeni**, që nënkupton njëjësin faqen, ndërsa për shumësin shkruhet **pëlqejini**, ato i **pëlqeni**.

“Ai raporton se ukrainasit po **i** rezistojnë pushtuesve...” (Lajmi.net), në vend se “ukrainasit po **u** rezistojnë pushtuesve”. “Unë **i** tregova të gjithë banorëve.” “Duhet t’i tregojmë banorëve për dhuratat që i bëri atyre Vëllai i Madh” (A. Osmani), në vend se “Unë **u** tregova të gjithë banorëve”. “Duhet **t’u** tregojmë banorëve për dhuratat që **ua** bëri atyre Vëllai i Madh” Udhëheqësja e “Bigbradhërit”, trajtat e shkurtra i keqpërdor vazhdimisht gjatë të folurit në emision, por edhe në rrjetet sociale.

Gabime të tilla, të njëjta, i vërejmë edhe në emisionin “E diela shqiptare”, të cilin e udhëheq Ardit Gjebea në Tv Klan. Ndërsa, i njëjti bën gabime edhe në të shkruar: “Mu desh të pres ca kohë ta shkruaj këtë gjë”, që duhet “**m’u** desh”. Pastaj: “Në gjithë botën mund ta shohin kur **t’ju** dojë zemra, gjë që, atyre **ju** pëlqen”. “20 vite më parë, NATO **i jep** fund masakrave të serbëve në Kosovë” që duhet të shkruhet: “20 vjet më parë, NATO-ja **u jep** fund masakrave (A. Gjebea).

Këto ishin vetëm disa nga gabimet e trajtave të shkurtra të përemrave vetorë që përdoren në mediet tona, ndërsa, gjejmë aq shumë, sa është e pamundur t’i përfshijmë të gjitha. **Përdorimet e gabuara të foljeve në vetën e tretë të mënyrës lidhore në kohën e tashme dhe të vetës së tretë njëjës në të ardhmen e mënyrës dëftore**, ngatërrohen shpesh me vetat e para të këtyre mënyrave. Veta e tretë njëjës, në të dyja këto mënyra, shkruhet **ai/ajo të punojë**, e jo **ai/ajo të punoj**, as **ai/ajo të punoi** (duke i ngatërruar me të tashmen dhe me të kryerën e thjeshtë të dëftores), por **unë (do) të punoj**, **ti (do) të punosh**, **ai/ajo (do) të punojë**. Po sjellim disa shembuj të marrë nga mediet tona: “Vrasjen e Ivanoviqit **mund ta zbuloi** vetëm ndonjë hetim i pavarur ndërkombëtar” (DEBAT PLUS, Dukagjini), që duhet shkruar “**mund ta zbulojë**”. “Përpyekjen që të gjejë fjalë që transmentojnë idenë që **ai do ta shpreh**” (LEXIMI LETRAR 8: f. 22), duhet të shkruhet “**idenë që ai do ta shprehë**”.

Po aty, në Tv Dukagjini, bëhen gabime drejtshkrimore shumë të mëdha, që është e dhimbshme t’i shohësh: “Haradinaj po tenton të **marr** rolin e liderit të opozitës”, që duhet shkruar **të marrë**. “Jemi në një gjendje që nuk e dimë sa **do të zgjas** dhe a **do të eskaloj** kjo situatë”, që duhet shkruar kështu: ...**që nuk dimë sa do të zgjasë** dhe a **do të eskalojë**. Nganjëherë veta e tretë e lidhore përdoret edhe **ai të punon**, si: “Nuk ka faj Donaldi që nuk mund **ta harron** Borën”, që duhet “**që nuk mund ta harrojë** Borën” (Unike News).

“Trajta e vetës së tretë njëjës e mënyrës lidhore, te të gjitha foljet, duke përfshirë edhe ato me tog zanor, shkruhet me -ë për arsye morfologjike” (Shqipërisë, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973, f. 55). Për të mos e bërë këtë gabim, duhet t’i bëjmë pyetje vetes, duke u munduar ta gjejmë kryefjalën se kush e bën veprimin (Kush? Ai **ta zbulojë**). *“Teas iu kërkua nga ndjekësit në Instagram që t’i lyej flokët”* (Info Kosova), që duhet shkruar **t’i lyejë flokët**. *“Klikoni këtu se kush mendoni që do të shkoj në finale, e kush do të qëndroj në shtëpi”* (A. Osmani), që duhen shkruar **“do të shkojë”** dhe **“do të qëndrojë”**.

“Serbia nuk dëshiron të nënshkruaj asnjë marrëveshje” (po aty), që duhet shkruar **të nënshkruajë**. *“Kurti do të jap dorëheqje”*, duhet të shkruhet **do të japë**. Shkarje të mëdha drejtshkrimore bëhen edhe në emisionin “Pressing” në televizionin T7, si: *“Kurti duhet të shkoj e të flas me serbet e Kosovës”*, që duhet të shkruhet: Kurti **duhet të shkojë e të flasë me serbet e Kosovës** etj. Ndërsa, për vetën e parë, në kohën e tashme të dëftores dhe të lidhores, në të shumtën e rasteve e shkruajnë **unë (të) punojë** në vend të **unë (të) punoj**: *“Më lejo të flasë derisa ta përfundojë”* (Pressing, T7), që duheshin shkruar: **unë të flas, unë të përfundoj**.

Ngatërrimi ndërmjet përemrave vetvetorë: vetë dhe i vet: *“Kjo qeveri do të rrëzohet vet nga paaftësia”* (Dukagjini), që duhet shkruar **“vetë”**, për t’u dalluar nga përemri tjetër që tregon pronësi **“i vet”, “e vet”, “të vetat”** etj. *“Zonja Ollbrajt e njohu dhimbjen tonë, sepse, edhe vet e kishte përjetuar”* (V. Osmani), që duhet të shkruhet **“vetë”**. *“Ngjyrat zbukurojnë ambientin tonë dhe ndikojnë në vet disponimin tonë”* (EDUKATA FIGURATIVE 4: f. 16), që duhet të shkruhet **“në vetë disponimin tonë”**. Gjithashtu, përemri vetvetor **vetë**, kur përdoret i paravendosur në fjalë të përngjitura, që shoqërohet me emra apo folje, të shumtën e herave përdoret gabim. Duhet ta kemi parasysh se, kur ky përemër takohet me një zanore nistore të fjalës, zanorja **ë** e përemrit nuk shkruhet, për t’mos u takuar dy zanore si: **vetizolim, vetedukim** etj., ndërsa kur shoqërohet me një fjalë që fillon me bashkëtingëllore, zanorja fundore **ë** e përemrit **vetë** ruhet si në fjalët: **vetëvendosje, vetëbesim, vetëdije** etj.

Mospërputhja e kryefjalës me kallëzuesin, për fat të keq, është një nga shkarjet e shpeshta në gazetatat elektronike. T’i shohim disa shembuj: *“Publiku duartrokitën dhe u ngritën në këmbë”* (Panorama), që duhet të shkruhet **“duartrokiti”** dhe **“u ngrit”**, për t’iu përshtatur kryefjalës **“publiku”**. *“Shteti i Kosovës ofruan ndihma për fëmijët e Ukrainës”*, duhet **“shteti ofroi”**, jo ofruan etj.

Mospërshtatja e mbiemrit me emrin dhe përdorimi i gabuar i shumësit të emrave

“Shqipja ka mbaresa të veçanta për trajtat rasore të numrit shumë, të dallueshme prej atyre të njëjësit. Si të tilla, ato shërbejnë edhe për shprehjen formale të shumësit” (Shqipërisë, 2002, f. 96). Në shumicën e medieve tona, shumësi i emrave përdoret në mënyrë të gabuar, sidomos i atyre mashkullorë që marrin prapashtesën **-ë**, por edhe të tjerët. *“Kryetari i parlamentit po flet me terma fetar”*, që duhet të shkruhet **“terma fetarë”**. *“Vetëvendosja nuk bën pazare as me deputet as me parti politike”*, që duhet të shkruhet: **“Vetëvendosja nuk bën pazare, as me deputetë, as me parti politike”** (Debat plus, Dukagjini). *“Mbi 20 autobus bartin qytetarët në votime”* (BOTA SOT), që duhet shkruar: **“Mbi 20 autobusë i dërgojnë qytetarët për të votuar”**. Pra, duhet të kemi kujdes edhe për kuptimin e fjalisë, kur shkruajmë. Në universitetin ku studioj (UEJL), njoftimet që më vijnë përmes adresës elektronike nga personat përgjegjës për shërbime studentore, gjithmonë shkruajnë me shumë gabime, që në hyrje të njoftimeve, si: togfjalëshi mbiemëror **“Të nderuar student”** duhet të shkruhet: **“Të nderuar studentë”**, sepse, ata i referohen shumësit, të gjithë studentëve. Politikanët tanë në rrjetet sociale, shumësin e emrave dhe gjymtyrët e dyta të tyre i shkruajnë me forma të njëjësit: **“Të dashur besimtar katolik”** (M. Kusari), që duhet: **“Të dashur besimtarë katolikë!”**.

Gjithashtu, duhet ta kemi parasysh, kur emri është në shumës, edhe mbiemri është në shumës, i cili merr veti të emrit, duke u përshtatur pastaj me të edhe në gjini e në rasë. Në këto raste, mbiemri kryen funksion sintaksor, si përcaktor me përshtatje, gjë që, nuk është e vështirë për t'u kuptuar, sikur të mund t'i kushtonin veç pak vëmendje personat përgjegjës që bëjnë shkarje gjuhësore, një mijë herë në ditë.

"Faktorët ndërkombëtar na mësuhan si të bisedojmë me Kurtin" (Pressing, T7), që duhet të shkruhet *"faktorët ndërkombëtarë"*. Teksa flasim për gabimet drejtshkrimore, *"Studentët.Mk"*, që në titujt e temave që trajtojnë shihen gabime: *"Përshtatja e përcaktorëve kallëzuesor me kryefjalët dhe kundrinat homogjene"*, që duhet të shkruhet *"përcaktorëve kallëzuesorë"*.

Emrit mashkullor në njëjës, edhe mbiemrit kur e shoqëron emrin, ia shtojnë *ë-në* fundore pa nevojë. *"Herë pas here, Elsa Lila është rikthyer për publikun shqiptarë"* (Fama), që duhet të shkruhet *"publikun shqiptar"* *"Ai ka hulumtuar emrat e mëdhenjë të politikës botërore"* (Kosova Post), që duhet shkruar: *"emrat e mëdhenj"*, ndërsa kur shquhet, shkruhet *"të mëdhenjtë"*. Andaj, duhet pasur kujdes, sepse, edhe gjymtyrët e dyta kanë gjymtyrë të dyta që duhen përshtatur me të parat në numër dhe në gjini.

Shkurtime e emrave të partive, të institucioneve, të shteteve etj., që hyjnë në grupin e emrave të përbërë të shkurtuar, duhet të shkruhen duke iu nënshtruar lakimit dhe duke marrë mbarekat rasore që ndahen me vizë. Kur këta emra mbarojnë me bashkëtingëllore, janë mashkullorë, ndërsa me zanore, janë femërorë.

Në rrjetet sociale, këta emra përdoren: *"Pse duhet të zgjedhim PD?"* (A. Krasta), që duhet shkruar *"PD-në"*. *"Unë e kam bërë të qartë rrugën që ta nënshkruajë PD, për t'u kthyer në një alternativë për njerëzit."* (L. Basha), që duhet shkruar: *"të nënshkruajë PD-ja"*. *"MASHT është përgatitur për fillim të mbarë të vitit"* (Telegrafi), që duhet shkruar *"MASHT-i"* etj.

Përyshkrimi i shquarësisë gjatë përdorimit të emrave të huaj ndodh çdo ditë dhe gjithkund në medie, si: *"Lajçak pajtohet që Kosovës i duhen hequr vizat"* (Klan Kosova), që duhet *"Lajçaku"*. *"Sekretari i NATO-s nuk është optimist për deklaratën e Putin"* (Dukagjini), që duhet të shkruhet *"për deklaratën e Putinit"*. *"Vuçiq nuk mund të nisë ushtri për në Kosovë"* (Pressing, T7), që duhet të shkruhet *"Vuçiqi"*. Emrat e huaj duhet të përshtaten me rregullat e fonetikës shqipe dhe t'u nënshtrohen paradigmave të gjuhës shqipe.

Përdorimi në mënyrë të gabuar i numërorit 3. Në mediet tona, në përgjithësi, bëhen ngatërresa gjatë përdorimit të këtij numri. Nuk është aq e vështirë për t'i dalluar *tri lule* dhe *tre zogj*. Duhet të dime të bëjmë dallimin, sepse numri 3 i ka dy gjinitë, për të përcaktuar sasinë e emrit. *"Tre herë ia mësynë familjes dhe kullës së Jasharajve"* (A. Kurti), që duhet të shkruhet *"tri herë"*.

"Tre janë lutjet që nuk refuzohen kurrë" (E. Rama). Duhet të shkruhet *"tri lutje"*, sepse numërori ndiqet nga emri i gjinisë femërore. *"Njëzetetë vjete më parë Gjakova përjetoi tmerrin e barbarisë serbe"* (R. Haradinaj), Së pari, *"njëzetetë vite"* është shkruar gabim, sepse, *"njëzetetë"* nuk është fjalë e përngjitur e numërorëve, por është shprehje lokutive, dhe numri *"tre"* është shkruar gabim, sepse nuk përshtatet me fjalën shoqëruese në gjini, e që duhet të shkruhet kështu: *"njëzet e tri vjet më parë"*. *"Në të trija këto pozita të portreteve, shprehet bota psikologjike."* (Edukata qytetare 7: 54), duhet të shkruhet *"të tria"*, pa *"j"* ndërmjet zanoresh. *"Lexoni tre tekste"* (GJUHA SHQIPE 8: f. 76), që duhet të shkruhet *"tri tekste"*. *"Kjo përbërje nga tre segmente mund të jetë e llojeve nga më të ndryshmet"* (ART FIGURATIV 7: f. 30), ku, përveçqë duhet të shkruhet *"tri segmente"*, sepse emri *segment* është ambigjen, kur kalon në shumës shndërrohet në femëror dhe, edhe numri i paravendosur duhet t'i përshtatet gjinisë, në fjali janë përdorur fjalë të panevojshme, ku ka mundur të shkruhet: *"Kjo përbërje nga tri segmente, mund të jetë e shumëllojshme"*.

Fjalitë pa kuptime përdoren shumë shpesh në mediet elektronike dhe të shkruara. Kjo pakuptimësi bëhet duke mos i ditur dhe duke mos i respektuar rregullat sintaksore. Në këtë mënyrë, fjalia shtrembërohet, sepse i mungon renditja e mirëfilltë e fjalëve. Në këso raste, kryefjalës që përmendet në një fjali, nuk i përshtaten gjymtyrët shoqëruese, as fjalët në përgjithësi, madje, mungojnë fjalët e duhura, përmes së cilave do të mund të arrihej marrëveshja gjuhësore. Ose, në disa raste, përmenden fjalë të tjera, të cilave u mungon kryefjala. Për shembull: “*Nisin punën me grevë*” (Lajmet, RTK). Kush e nisin punën me grevë? Do përmendur kryefjala: “*Mjekët nisin punën me grevë*”.

Pastaj, “*Rryma në Mitrovivë zgjidhet nëpërmjet dialogut Kosovë-Serbi*” (ATV), që duhet të shkruhet: “*Çështja e rrymës elektrike në Mitrovivë zgjidhet përmes dialogut Kosovë-Serbi*”. Një shembull tjetër: “*Çdo ditë kemi ikje nga vendi*” (ATV). Ikje të kujt? Çfarë ikje? Që duhet të shkruhet: “*Çdo ditë kemi ikje të qytetarëve (të të rinjve) nga vendi*”. “*Vetëm një autobus shkoi për të votuar në Medvegjë*” (Klan Kosova). Autobusi nuk shkon për të votuar. Votojnë qytetarët. Duhet të shkruhet: “*Vetëm një autobus u nis për në Medvegjë, për t’i dërguar qytetarët që të votojnë*”. Vlen për t’u theksuar se, kryefjala në shumë raste nënkuptohet, por në shembujt e sipërpërmendur është e nevojshme që ajo të përmendet.

“*Cilët janë artistët shqiptarë që bënë burg në Itali*” (Panorama), që duhet shkruar “*që qenë të burgosur*”, sepse artistët shqiptarë nuk e bënë burgun, por kanë qenë të burgosur në atë burg. Fjalisë duhet të ia ruajmë kuptimin, duke i përshtatur me kujdes pjesët e ligjëratës që i vëmë në përdorim njëherë me tjetrën. “*Sa vite burg mund të dënohet Elsa Lila*”, duhet të shkruhet “*sa vjet*”, sepse pyetet për sasi, ndërsa përgjigja do të jetë me **vjet**, me një numëror përpara emrit **vjet**, p. sh.: *sa vjet, 2 vjet, shumë vjet, disa vjet* etj. “*Shumësi i emrit vit i ka dy forma: vjet dhe vite*.” (Memushaj, 2017, f. 66). Trajta **vjet-ët** përdoret kur emri shoqërohet me një numëror ose fjalë që tregojnë sasi, si përemrat e pacaktuar: *disa vjet më parë, shumë vjet më parë, 3 vjet, pak vjet më vonë* etj.

Ndërsa, në të gjitha rastet e tjera, shumësi i emrit **vit**, kur nuk shoqërohet prej fjalëve të mësipërme, shkruhet **vite-t**: *vitet e studimeve, vitet e rinisë, vitet e fundit, vite të bukura* etj. Por, kur emri **vit** (në shumës), në të njëjtën kohë ka të paravendosur edhe numrin, edhe një përcaktor shoqërues, atëherë duhet shkruar *vite*: *3 vite të bukura, vitet e studimeve, vite të paharrueshme, vitet e gjimnazit, vitet e rinisë,* etj. Ndërsa, fjala **vjet** përdoret edhe me kuptim ndajfoljor që tregon kohë: *vjet kam diplomuar, vjet ka qenë dimri më i ftohtë, sesa sivjet* etj. Një ndër rregullat parësore sintaksore është kuptimi që duhet ta marrë fjalia gjatë organizimit të fjalëve brenda saj, pa të cilin, ajo mund ta humbasë mesazhin gjuhësor.

Gjithashtu, duhet ta kemi parasysh të mos bëjmë përsëritje të fjalëve që mbartin të njëjtin kuptim, sepse krijohet tautologji në fjali, si: “*Janë një mori e madhe faktorësh që ndikojnë që të rritet numri i shkurorëzimeve, si: faktorët psikologjik, psikofiziologjik, social dhe socio-kulturor*”, dhe pak më poshtë tekstit shkruan: “*disa mori të mëdha faktorësh*”! (Expres). E gjithë fjalia është shkruar gabim. Së pari është krijuar tautologji kuptimesh “*një mori e madhe faktorësh*”, që duhej shkruar: “*shumë faktorë*” ose “*disa faktorë*”, pastaj shumësi i përcaktorëve të emrit është shkruar në mënyrë të gabuar, që duhej shkruar: “*faktorët psikologjikë, psikofiziologjikë, socialë dhe socio-kulturorë*.” Pastaj, “*Për një muaj 119 çifte i dhanë fund martesës në Kosovë*” (Express), që duhet të shkruhet: “*Për një muaj, 119 çifte në Kosovë, u dhanë fund martesave të tyre*.”, sepse, krejt çiftet nuk kanë qenë të martuara bashkë, “*martesës*”.

Shkrimin ndaras të disa fjalëve, kur duhet të shkruhen bashkë dhe anasjelltas e vëmë re kudo, gati në të gjitha gazetate elektronike e në edicione lajmesh. “*Në vend ngjarje ndodhet grupi hetimor*” (Panorama), që duhet shkruar “*vendngjarje*”, sepse është fjalë e përbërë prej dy emrash. “*Përballë Kurtit, më shumë duken si shefa grupesh parlamentare, se sa si politikanë që*

presin të marrin pushtetin” (Berat B.: Nacionale). Në këtë periudhë nënrenditëse, lidhëza *sesa*, duhet të shkruhet bashkë, sepse është lidhëz krahasuese që shërben për të lidhur fjalinë e varuar me fjalinë drejtuese, ndërsa *se sa* mund të përdoret në raste të tjera, si: *Nuk e di se sa ditë do të jem në Tiranë*. I njëjti person, përsërit të njëjtin gabim: *“Secili analist mesatar pëlqehet më shumë se sa Krasniqi”*, që duhet të shkruhet *“sesa”*.

Të shkruarit gabim i disa ndajfoljeve ndodh shumë shpesh. *“Do të punoj pa rreshtur në këtë punë.”* (L. Basha), që duhet të shkruhet bashkë *pareshitur*, me strukturë të mbyllur. *“Libri i sapo botuar i Majlindës...”* (M. Kusari), duhet shkruar: *“i sapobotuar”*. *“Ka pasur sjellje jo etike të operatorëve me rritje çmimesh”* (Dukagjini), që duhet të shkruhet *“joetike”*.

“Jeta të përplas në vështirësi pafund” (A. Gjebrea), që duhet shkruar *“Jeta të përplasë në vështirësi pa fund”* me strukturë të hapur, me parafjalën *pa* në pozicion para emrit *fund*. Kur shkruhet si mbiemër, shkruhet bashkë *“i/e/të/së pafund”*, *“i/e/të/së pafundme”*, pastaj si ndajfolje *“pafundësisht”* etj. Gabim është shkruar edhe përemri i pacaktuar *“çdonjëri”*: *“Çdo njëri nga ne duhet të ndihet i dashur”* (A. Kurti). Kjo fjalë shkruhet bashkë, ndërsa kur themi *çdo njeri*, shkruhet ndaras. *“E di, deri sa të shoh diellin e yjet, do të jesh me mua!”* (E. Rama). Lidhëza *“derisa”* që tregon vazhdimin e veprimit deri në një kohë të caktuar ose që përcakton një cak kohor, shkruhet bashkë.

Folja modale “mund” në funksion të kallëzuesit të përbërë foljor, duhet të dalë e ngurosor, gjithmonë, në rastet kur shoqërohet nga një folje e mënyrës lidhore, e jo si në këtë fjali: *“Grupi i të larguarve nuk mundet të arrij më shumë pa Albinin, e nuk munden nga jashtë ta kopjojnë.”* (Bota Sot), që duhet të shkruhet *“Grupi i të larguarve “Grupi nuk mund të arrijë e nuk mund ta kopjojë...”*, sepse, në mënyrën si e kanë shkruar, folja *“mund”* nuk është më modale, por folje me kuptim të plotë leksikor. Ndërsa, *“nuk munden nga jashtë ta kopjojnë”* në shumës, nuk përshtatet sintaksorisht me *“grupi i të larguarve”* që është në njëjës, pra nuk përshtatet kryefjala me kallëzuesin.

Gabime drejtshkrimore në libra shkollorë ka pa fund. Kallëzuesit e përbërë foljorë janë shkruar kështu: *“arriti të pushtoi”*, në vend se *“arriti të pushtojë”*, sepse folja shoqëruese është në vetën e tretë të lidhore, e jo mbaresa të marrë formatet e të kryerës së thjeshtë. *“Arriti të shkëput”*, duhet të shkruhet *“të shkëputë”*, sepse i referohet vetës së tretë të lidhore, *ai*.

Përdorimi i fjalëve të huaja në vend të fjalëve shqipe është një dukuri mjaft e përhapur në mediet tona elektronike dhe atyre të shkruara. Ne mund t’i përdorim vetëm në rastet kur nuk kemi fjalë sinonime për ta thënë ndryshe fjalën (sepse disa fjalë të huaja, domosdoshmërisht duhen përdorur), por, jo kur e kemi mundësinë ta shkruajmë shqip. *“Gruaja që ishte divorcuar nga bashkëshorti, jetonte në Tiranë”* (Panorama), që duhet të shkruhet *“ishte shkurorëzuar”*.

Në reklamat e vendosura në rrugën ndërqytetëse “Arbën Xhaferi” që lidh Kosovën me Maqedoninë Veriore, shkruan: *“voztje të mbarë!”* në vend se *“ngasje të mbarë!”* Në vend se: *unë ngas, ti nget, ai/ajo nget*, ne *ngasim*, ju *ngitni-ngisni*, ata/ato *ngasin*. Përdorimi i fjalëve të huaja në gjuhën tonë është i panevojshëm, sepse shqipja është e pasur me fjalë sinonime për t’i ardhur në ndihmë folësit.

Për shembull, në fjalinë *unë vozit makinën*, folja *vozt* (serb. *ja vozim-ja возим*), përdoret shumë në gjuhën shqipe, madje, edhe në medie, në vend se, *unë ngas*. Pastaj, *“vozt me kujdes”* ose *“voztini me kujdes”*, *“mos vozit-mos vozitni”*, në vend se *mos ngit-mos ngitni* ose *mos ngisni*. Ndaj, edhe si emër, edhe si folje, përdoren vazhdimisht te ne: *voztje; unë vozis* ose *unë vozit*.

Përfundim

Deri këtu u panë vetëm disa shembuj nga gabimet e shumta drejtshkrimore të medieve tona në përgjithësi. Për ta zhdukur këtë dukuri të dëmshme për gjuhën shqipe, duhet të ndërmerren hapa të nevojshëm për të mos lejuar që gjuha shqipe të marrë “forma të reja” të të shkruarit, në të cilat mund të mbështeten gjeneratat e ardhshme, duke pasur mundësi të ndiqen format e drejtshkrimit të gjuhës shqipe të standardizuar pesëdhjetë vjet më parë.

Lidhur me këtë, jepen disa rekomandime. Së pari, në shtëpitë botuese, duhet të punësohen persona (lektorë) që i përgjigjen plotësisht detyrës së marrë përsipër, pra që e njohin mirë fushën e drejtshkrimit, në mënyrë që në librat shkollorë (dhe në çfarëdolloj libri që botohet) mos të ketë gabime. Në çdo fakultet duhet të ketë një lëndë të veçantë kushtuar drejtshkrimit dhe të mbahen ushtrime në klasa rreth kësaj çështjeje, sepse, çfarëdo të studiojë një i ri shqiptar, duhet të dijë të shkruajë, sadopak, shqip. Të organizohen e të ndiqen kurse për drejtshkrimin, në shihet e nevojshme për studentë.

Gjithashtu, në çdo institucion gazete, qoftë të shkruar, qoftë elektronike, të ketë lektorë e redaktorë të kualifikuar, për të mos dalë aq qesharakë para opinionit publik ata që shkruajnë, ku bëhen gabimet më elementare gjuhësore. Secili që merret me një detyrë të caktuar, e cila ka të bëjë drejtpërdrejt me shkrimin, duhet ta ketë, së paku, një fjalor që do t’i ndihmojë shumë për të njohur drejtshkrimin, sepse, më mirë është të sigurohet secili për atë që shkruan, sesa ta marrë si nënvlerësim për veten për të shikuar dhe për të kontrolluar në një fjalor, e të gabojë vazhdimisht.

Fjalorët e gjuhës shqipe duhet t’i mbajë secili student, sidomos ata që studiojnë gjuhën shqipe, të cilët duhet të jenë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm gjatë studimeve, që t’i fitojnë njohuritë rreth fleksionit të gjuhës shqipe, duke ditur se shqipja ka eptim të gjerë dhe fjalët pësojnë shumë ndryshime kur u nënshtrohen paradigmave të lakimit dhe të zgjedhimit. Po ashtu, profesorët universitarë, duhet të jenë më të përgatitur kur hapin dritare në projektorë para studentëve, që t’i evitojnë dhe t’i eliminojnë gabimet drejtshkrimore, sepse ata u shërbejnë si modele studentëve, ku një numër i madh studentësh i mbështetin dhe i përforcojnë mendimet dhe rregullat e një profesori.

Të rinjtë, të lexojnë sa më shumë libra (fjalorë normativë të gjuhës shqipe, libra të gramatikës së standardit, të leksikologjisë etj., pastaj libra të letërsisë si : lektyra, novela, romane, poezi etj.), në mënyrë që ta pasurojnë të shkruarit e të folurit dhe t’i përkapin njohuritë e duhura e të sakta, gjë që mund të çojë në reduktimin e përdorimit të komunikimit elektronik të gabuar. Andaj, duhet që të gjithë studentët e gjuhës shqipe, të gjithë profesorët, të gjithë gjuhëtarët, ta mbrojnë gjuhën shqipe nga shtrembërimet, nga shkeljet e nga humbja e formës së saj të bukur. Nëse ata nuk e mbrojnë gjuhën shqipe, nuk do ta mbrojnë askush tjetër.

Literatura

- [1]. Beci, Bahri. (2010). *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*. Tiranë: EDFA.
- [2]. Çeliku, Mehmet. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe*. Tiranë: ILAR.
- [3]. Memushaj, Rami. (2017). *Shqipja standarde*. Tiranë: INFBOTUES.
- [4]. Murati, Qemal. & Dulaj, Fridrik. (2021). *Kulturë e gjuhës dhe kulturë e të shprehurit*. Gjakovë: Universiteti "Fehmi Agani".
- [5]. Shkurtaj, Gjovalin. (2017). *Si të shkruajmë shqip*. Tiranë: ENEAS.
- [6]. Shqipërisë, Akademia. e. (1973). *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- [7]. Shqipërisë, Akademia. e. (1980). *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- [8]. Shqipërisë, Akademia. e. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- [9]. Shqipërisë, Akademia. e. (2006). *Fjalor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- [10]. Beci, Bahri. (2010). *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*. Tiranë: EDFA.
- [11]. Çeliku, Mehmet. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe*. Tiranë: ILAR.
- [12]. Memushaj, Rami. (2017). *Shqipja standarde*. Tiranë: INFBOTUES.
- [13]. Murati, Qemal. & Dulaj, Fridrik. (2021). *Kulturë e gjuhës dhe kulturë e të shprehurit*. Gjakovë: Universiteti "Fehmi Agani".
- [14]. Shkurtaj, Gjovalin. (2017). *Si të shkruajmë shqip*. Tiranë: ENEAS.
- [15]. Shqipërisë, Akademia. e. (1973). *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- [16]. Shqipërisë, Akademia. e. (1980). *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- [17]. Shqipërisë, Akademia. e. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- [18]. Shqipërisë, Akademia. e. (2006). *Fjalor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.